

STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Peqin Souvenir” sh.p.k

Në bazë të ligjit nr.9001.dt.14/04/2008. “Për Shoqëritë Tregtare”

KREU I
THEMELIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1
THEMELIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **“Peqin Souvenir”** sh.p.k themelohet më datë **09 shtator 2025**, në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortaku i vetëm i shoqërisë është **Enri Hasa**, i pajisur me dokument identifikimi J50525033P, i cili zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë. Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2
OBJEKTI

“Shoqëria ka për qëllim kryerjen e tregtimit me shumicë dhe pakicë të suvenireve, artikujve industrial të ndryshëm dhe dhuratave me karakter kulturor, artistik apo personal. Importin, eksportin dhe shpërndarjen e aksesorëve dekorativë për ambiente të brendshme dhe të jashtme, përfshirë mobilje të vogla, ndriçues objekte artizanale, piktura, vazo etj. Tregtimin e luleve natyrale dhe artificiale, si dhe aksesorëve të lidhur me floristikën dhe dekorimin me lule. Shitjen e artikujve dhe shërbimeve në fushën e dekorimit për festa dhe evente. Shitjen online përmes platformave dixhitale si dhe ofrimin e porosive me dërgesë në adresë. Kryerjen e çdo veprimtarie tjetër të ligshme që lidhet me objektin e mësipërm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Neni 3
KOHËZGJATJA

Shoqëria ka kohëzgjatje të pacaktuar.

Neni 4
SELIA

Selia e shoqërisë është: **Lagja Xhami Peqin, Kati i parë, Njësi tregtare me Nr pasurie 13/146, zona kadastrale 2908**. Shoqëria mund të hapë filiale, degë ose përfaqësi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

E-1~

KREU II KAPITALI

Neni 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i zotëruar 100% nga ortaku i vetëm Enri Hasa.

Neni 6 ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me ligjin dhe këtë statut.

Neni 7 TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë
- shitblerjes
- trashëgimisë
- dhurimit
- çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferushme nga Ortaku i kësaj shoqërie, tek të tretët që nuk janë pjesë e Shoqërisë. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferushme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET DREJTUESE

Neni 8 ORGANI VENDIMARRËS

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ushtrohet nga Ortaku i Vetëm **Enri Hasa**, i cili merr çdo vendim të parashikuar nga ligji dhe ky statut.

Neni 9 MËNYRA E VENDIMARRJES SË ORTAKUT TË VETËM

Të gjitha vendimet që lidhen me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, si dhe çdo çështje tjetër që sipas ligjit kërkon vendimarrje nga asambleja e përgjithshme, merren nga Ortaku i Vetëm, Z. Enri Hasa. Çdo vendim ligjor i marrë nga Ortaku i Vetëm, Z. Enri Hasa, dokumentohet në formë shkrese të firmosur fizikisht. Proçesverbali përmban datën, subjektin dhe përmbajtjen e vendimit. Vendimet hyjnë në fuqi menjëherë sapo të nënshkruhen, pa nevojën për thirrje, afate apo kuorum. Për çdo çështje, normat për shumicë të zakonshme dhe të kualifikuar zbatohen ekzekutivisht nga Ortaku i Vetëm.

Neni 10

ADMINISTRIMI

Administratore e shoqërisë është znj. Valbona Hasa, e emëruar me vendim të ortakut të vetëm, datë 09.09.2025, me mandat **5 (pesë) vjet** deri më datë 09.09.2030, me të gjitha kompetencat e parashikuara nga ligji dhe ky statut.

Neni 11

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORES

Administratorja përfaqëson dhe administron shoqërinë, duke zbatuar politikat e përcaktuara nga Ortaku i Vetëm. Ajo është përgjegjëse për:

- Mbajtjen e dokumentacionit dhe librave kontabël
- Përgatitjen dhe paraqitjen e bilancit vjetor dhe raportit të veprimtarisë
- Regjistrimin e të dhënave pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit
- Raportimin për veprime me rëndësi të veçantë
- Marrjen e masave në rast rreziku financiar për shoqërinë
- Thirrjen e Ortakut të Vetëm në rastet e parashikuara nga ligji
- Kryerjen e çdo detyre tjetër sipas ligjit dhe statutit

Nëse emërohen më shumë se një administrator, ata ushtrojnë kompetencat bashkërisht. Administratorët mund të shkarkohen në çdo kohë nga Ortaku i Vetëm.

Neni 12

PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORES

Administratorja është përgjegjëse individualisht ndaj shoqërisë dhe të tretëve për çdo veprim ose mosveprim që përbën shkelje të ligjit, statutit apo detyrave të tij gjatë administrimit.

Ajo detyrohet të:

- Veprojë në mirëbesim, me profesionalizëm dhe në interesin më të mirë të shoqërisë
- Parandalojë konfliktet e interesit dhe të ushtrojë kompetencat vetëm për qëllimet e shoqërisë
- Dëmshpërblejë shoqërinë për çdo dëm të shkaktuar nga veprime të parregullta, përfshirë fitimet personale të realizuara në kundërshtim me ligjin
- Mbajë barrën e provës për të vërtetuar se ka vepruar sipas standardeve të kërkuara

Në rast shkeljesh të kryera nga më shumë se një administrator, përgjegjësia është solidare. Ortakët kanë të drejtë të ngrenë padi civile ose penale për dëmet e shkaktuara, dhe asnjë vendim nuk mund të ndalojë këtë të drejtë.

KREU IV
VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 13
VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 14
EKSPERTET

Shoqëria mund të angazhojë ekspert kontabël të autorizuar për kontrollin e dokumentacionit financiar dhe përgatitjen e raportit të bilancit vjetor, sipas nevojës dhe vendimit të Ortakut të Vetëm. Raporti i ekspertit, kur përgatitet, i dorëzohet Ortakut të Vetëm për shqyrtim dhe miratim.

Për çdo çështje që nuk parashikohet shprehimisht në këtë statut, zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 15
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shoqëria mund të shpërndahej ose të priset në këto raste:

- Me përfundimin e afatit të parashikuar në themelim
- Me vendim të Ortakut të Vetëm
- Me hapjen e procedurave të falimentimit
- Nëse nuk ka ushtruar veprimtari për dy vite pa njoftuar pezullimin sipas ligjit
- Me vendim gjykatë

Në rast prishjeje, Ortaku i Vetëm cakton likuidatorin/ët dhe përcakton mënyrën e likuidimit. Në të gjitha dokumentet zyrtare të shoqërisë gjatë kësaj faze, shtohet emërtimi “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Procedurat e likuidimit nisin menjëherë pas vendimit për prishje. Brenda 30 ditëve, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës për caktimin e likuidatorit, nëse nuk është bërë nga Ortaku i Vetëm.

Neni 16
RIORGANIZIMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të bashkohet ose të ndahet me vendim të Ortakut të Vetëm, në përputhje me dispozitat e Pjesës IX të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 17
BAZA LIGJORE

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me këtë statut dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi. Për çdo çështje që nuk parashikohet në statut, zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901, Kodit Civil dhe çdo ligji tjetër përkatës në Republikën e Shqipërisë.

Neni 18
MOSMARRVESHJET

Mosmarrëveshjet që lidhen me zbatimin ose interpretimin e këtij statuti, si dhe ato që lindin ndërmjet shoqërisë dhe palëve të treta, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Më datë 09/09/2025

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Peain Souvenir”

Enri Hasa

Elm